



BPAL - PIHA
Kolegji Universitar "BIZNESI"
University College "BIZNESI"
Prishtinë

**Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit Universitar "Biznesi" në Prishtinë,
Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit Universitar "Biznesi" më
14. 07. 2010 miratoi këtë:**

RREGULLORE

PËR POLITIKAT E KOLEGJIT UNIVERSITAR "BIZNESI" PËR PËRDORIMIN E RRJETIT TELEFONIK

Me këtë Rregullore përcaktohet politika e KU "Biznesi", kushtet dhe mënyra e përdorimit të rrjetit telefonik në pajtim me ligjin dhe statutin e KU "Biznesi".

1. E drejta e përdorimit

1.1. Të drejtë përdorimi të rrjetit telefonik kanë të gjithë personat të cilët janë në marrëdhënie pune. Studentëve u lejohet përdorimi i rrjetit telefonik me leje dhe arsyetim të posaçëm nga organi përkatës. Organet përkatëse janë: dekani, përgjegjësit e departamenteve dhe udhëheqësit e sektorëve.

1.2. Përdorimi i rrjetit telefonik shfrytëzohet për kryerjen e detyrave, obligimeve dhe qëllimeve zyrtare të KU "Biznesi". Përdorimi i rrjetit telefonik për qëllime private pa autorizim nga organet përkatëse sanksionohen materialisht.

1.3. Me qëllim të sigurojë shërbim efikas, Dekani miraton politika që përkufizojnë qasjen në rrjet për individët dhe llojet e thirrjeve (lokal, nacional, mobil, ndërkombëtar). Përdorimi jashtë këtyre kufijve do të sanksionohet materialisht.

2. E drejta dhe obligimet e shërbyesit në centralin telefonik

2.1. Personi shërbyes kërkohet të njohë gjuhën shqipe dhe anglishte.

2.2. Personi shërbyes kryen punën e vet pa u penguar dhe keqkuptuar. Personi shërbyes për punën e kryer i përgjigjet përgjegjësit të TI-së dhe përgatit raport mujor. Raporti mujor duhet të përfshijë realizimin e thirrjeve dhe harxhimet për çdo shfrytëzues.

2.3. Personi shërbyes obligohet të përgjigjet në të gjitha thirrjet. Se cilat transfere lejohen dhe cilat janë të ndaluara përcaktohet nga Rregullorja e miratuar nga Këshilli i lartë mësimor-shkencor i KU "Biznesi" në bashkëpunim me dekanin.

2.4. KU "Biznesi" obligohet në mbrojtjen e integritetit të personit shërbyes. KU "Biznesi" kërkon përgjegjësi nga personi shërbyesi në rast të kryerjes keq të punës apo sjelljes jo të mirë.



Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan